

VENDIM
Nr. 775, datë 19.12.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 2 ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË
DHE TRANSPORTIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR ME QASJE
PROGRAMATIKE ME SHUMË FAZA”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 62/2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2 me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”, ratifikuar me ligjin nr. 62/2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 9030 prot.

Tiranë, më 06.2025

Lënda: Mbi Projektin “Për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”.

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
Adresa: “Dëshmoret e 4 Shkurtit” nr.34 Tiranë

Për dijeni: **XIAOQING YU**
Drejtores Rajonale, Ballkani Perëndimor

Refereuar marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”, me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t’u financuar nga kjo marrëveshje nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

-shtyrjen deri më 15 Qershor 2027, të afatit të parashikuar sipas skedulit 2, neni III (B.2) të marrëveshjes së huas.


Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese nr.2 me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”.

Ky ndryshim hyn në fuqi, në datën e njoftimit nga pala shqiptare të Bankës Botërore mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

MINISTRI

Petrit Malaj



Logo **BANKA BOTËRORE**
BNRZH – IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

XIAOQING YU
Drejtore Divizioni, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

20 nëntor 2025

SH. T. Petrit Malaj
Ministër
Ministria e Financave
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr. 3, Tiranë
Shqipëri

Projekti për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor
(Huaja nr. 8933-AL)
Zgjatja e Datës së Mbylljes

I nderuar Z. Ministër,

I referohemi Marrëveshjes së Huasë të Projektit për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor (P162043), (Huaja nr. 8933-AL) të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”), të datës 19 qershor 2019. Gjithashtu, i referohemi letrës suaj të datës 9 qershor 2025, me anë të së cilës Bankës i kërkohet zgjatja e Datës së Mbylljes së Huasë të lartpërmendur.

Kemi kënaqësinë t’iu informojmë se Banka ka caktuar datën 15 qershor 2027 si datën për qëllime të Seksionit III.B.2 të Skedulit 2 të Marrëveshjes së Huasë.

Në pritje të vijimit të bashkëpunimit tonë dhe mbështetjes së objektivave të zhvillimit të Shqipërisë.

Me respekt,
(Nënshkrimi)

Xiaoqing Yu
Drejtore Divizioni për Ballkanin Perëndimor
Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni:

SH.S. Delina Ibrahimaj, Ministre, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Z. Endrit Yzeiraj, Zëvendësministër i Financave
Z. Enkelejd Musabellu, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit
Zj. Enkelejda Muçaj, Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
Z. Eldi Çondi, Shef Kabineti, Ministria e Financave
Zj. Eridana Çano, Drejtuese e SASPAC
Zj. Llambriola Misto, Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Zj. Viola Haxhiademi, Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Zj. Erjola Muka, Drejtore e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Zj. Veronika Korkaj, Drejtore e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme për Financimin dhe Kontraktimin e Fondeve të BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë /CFCU, Ministria e Financave
Z. Mihail Cico, Drejtues i TTFP 1.0 PIU
Z. Matteo Bugamelli, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore